Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	6	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia Per Vit	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Shërbim i Linjave DARKFIBER OSHEE HQ – Nënstacioni OSHEE 110 kV Selitë	1			
2.	Shërbim i Linjave DARKFIBER OSHEE HQ – Nënstacioni OST 220/110 kV Tirana 2	1			
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

TERMAT E REFERENCËS DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbim i Linjave Dark Fiber OSHEE HQ – Nënstacioni OSHEE 110 KV Selitë, OSHEE HQ - Tirana 2 OST 220/110 KV

Objekti i Kërkesës: Vënia në dispozicion e shërbimit të linjave me qira për dy çifte të dedikuara të fibrave optike me destinacionet:

1. OSHEE HQ – Nënstacioni OSHEE 110 kV Selitë
2. OSHEE HQ – Nënstacioni OST 220/110 kV Tirana 2

OSHEE sh.a. po implementon systemin e ri SCADA. Në kuadër të realizimit të një lidhjeje të sigurtë të sistemit qendror me nënstacionet, OSHEE sh.a. kërkon të lidhë me fibër optike (dark fiber) Zyrat Qendrore me nënstacionin e Selitës.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate shërbimi është sigurimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm midis Zyrave Qendrore të OSHEE Group sh.a. dhe Nënstacionit të Selitës të vendosur në zonën e Selitës, Tiranë.


Për realizimin e komunikimit midis Zyrave Qendrore të OSHEE Group sh.a. dhe Nënstacionit të Selitës, ofertuesi do të duhet të ofrojë dy fije fibre optike të pandërprera, të cilat duhet të ofrojnë kapacitetin jo më të vogël se 1Gbps.

Lidhja duhet të jetë e disponueshme dhe funksionale pa pasur defekte 99.99% të kohës 24 orë/7ditë/12 muaj. Përfundim bëjnë rastet kur disponueshmëria ndërpritet për shkaqe jo për faj të ofruesit të shërbimit. Hapësirat kohore për mirëmbajtje të planifikuara në sistem nuk ndikojnë në matjen e disponueshmërisë.

Në rastet kur nevojitet më tepër kohë për ndërhyrje, afati i parashikuar për zgjidhjen duhet të njoftohet paraprakisht, i shoqëruar me arsyetim. Në rastin kur afati parashikohet më shumë se 1 (një) ditë ai miratohet nga ndjekësit e kontratës.

Lokacionet e Përfshira:

- **HQ OSHEE:** 41°19'16.90"N, 19°48'5.25"E
- **Nënstacioni OSHEE Selitë:** 41°18'50.94"N, 19°47'33.14"E
- **Nënstacioni OST Tirana 2:** 41°20'49.32"N, 19°48'53.82"E



Kerkesat Teknike:

- **Kapaciteti i Linjës:** Sigurimi i kapacitetit të lartë transmetimi për të mbështetur aplikacionet kritike të sistemit të energjisë.
- **Qëndrueshmëria:** Garanci për qëndrueshmëri të lartë dhe minimizim të ndërprerjeve, duke përfshirë zgjidhje redundante për sigurinë e maksimumit të operacioneve.
- **Monitorimi dhe Mbështetja:** Monitorimi i vazhdueshëm dhe mbështetje teknike 24/7 për adresimin e çdo çështjeje teknike brenda një afati kohor të shkurtër.

Kushtet Financiare:

- **Periudha e Kontratës:** 12 muaj.
- **Monedha e Çmimit:** Të gjitha çmimet do të jepen në lekë.
- **Taksat:** Çmimet përfshijnë të gjitha taksat përveç TVSH-së.
- **Oferta Financiare:** Të përfshihet një çmim total për një zgjidhje të plotë operationale, siç është specifikuar nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e Linjës :

Linja duhet të jete e dedikuar pike me pike drejt DC OSHEE Tirane e gatshme për tu futur në folenë përkatëse në pajisjen e rrjetit kompjuterik (router, firewall etj.) .

PËRSHKRIMI I KËRKESAVE TË ZBATIMIT TË SHËRBIMEVE NË LIDHJE F.O

Aktivizimi i shërbimit: Pas instalimit të shërbimit të fibrës optike, për aktivizimin e tij kërkohet një kërkesë zyrtare nga autoriteti kontraktor. Ky proces ndodh pas nënshkrimit të kontratës dhe para fillimit të

përdorimit të shërbimit. Me këtë kërkesë, autoriteti kontraktor bën të ditur nevojën për fillimin e shërbimit të fibrës optike.

Funksionimi pa ndërprerje: Kontraktuesi është përgjegjës për sigurimin e funksionimit të përhershëm të linjës së fibrës optike. Në këtë kontekst, linja duhet të jetë aktive dhe e pa ndërprerë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Komunikimi i mbikëqyrur dhe pa ndërprerje është i rëndësishëm për shërbimin e ofruar.

Mirëmbajtja e linjës: Përveç instalimit të linjës së fibrës optike të zeze të dedikuar, kontraktori ka përgjegjësinë e mirëmbajtjes së kësaj linje. Ky aspekt përfshin monitorimin dhe mbikëqyrjen e linjës për të parandaluar ndërprerjet e shërbimit, zhurmën e panevojshme ose deformimet e sinjalit. Kontraktuesi duhet të sigurojë që linja të funksionojë në mënyrë optimale në të gjitha kohërat gjatë kontratës.

Testimi i linkut: Dorëzimi i shërbimit konsiderohet i përfunduar pas testimit të linkut të fibrës optike. Kontraktori është përgjegjës për kryerjen e testeve të cilësisë së linjës përmes mjeteve të veta të matjes së sinjalit dhe raportimit të sinjalit dhe zhurmës. Rezultatet e testimit duhet të dokumentohen dhe të dorëzohen si pjesë e procesit të pranimit të shërbimit. Testimi i linjës duhet të realizohet në stacionet fundore ku lidhja përfundon.

Sigurimi i informacionit: Ofruesi i shërbimit të fibrës optike duhet të sigurojë informacionin e nevojshëm në kohë për autoritetin kontraktor. Kjo përfshin informacionin mbi pronarin e tubacionit, linjat nëntokësore ose ajrore, moshën e fibrave, llojin e instalimit, si dhe amortizimin aktual në rrugë. Ofruesi i shërbimit që mundëson informacion të plotë dhe aktual në lidhje me këto kërkesa ka përparësi gjatë paraqitjes së ofertës fillestare.

Detajet e infrastrukturës: Autoriteti kontraktor ka nevojë për detajet e infrastrukturës së instaluar për fibrën optike. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë të dhënat mbi llojin e instalimit, rrugën që ndjek linja kabllore, numrin e xhuntove bashkuese në rrjet, buxhetin optik dhe të gjitha informacionet e rëndësishme të infrastrukturës. Përpara se të vazhdojë me aktivitetet e zbatimit, ofruesi i shërbimit duhet të marrë aprovimin e autoritetit kontraktor në fazën e vlerësimit teknik të tenderit.

Përshkrimi i teknikës së përdorur: Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë zgjidhjen teknike dhe bllok skemën e plotë për zgjidhjen e ofruar, ku përshkruhen në detaj teknologjitë e përdorura. Për teknologjinë që operatori ekonomik do të përdorë, duhet të paraqesë licencën përkatëse të lëshuar nga

AKEP.Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar të teknikës së përdorur për infrastrukturën e fibrës optike në përdorim. Ky përshkrim duhet të plotësojë kërkesat e autoritetit kontraktor dhe të përfshijë informacione të rëndësishme për mbikëqyrjen dhe metodat e mirëmbajtjes së infrastrukturës së fibrës optike.

Koordinimi me Projekte të Tjera Infrastrukturore: Kontraktori duhet të demonstrojë aftësinë për të koordinuar instalimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së fibrës optike me projekte të tjera infrastrukturore që ndodhin në të njëjtën zonë për të minimizuar ndërhyrjet dhe për të optimizuar kohën e realizimit të projektit.

Trajnimi dhe Certifikimet: Kontraktori duhet të sigurojë që stafi i angazhuar në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjës së fibrës optike të jetë i trajnuar dhe të posedojë certifikatat përkatëse që garantojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të menaxhuar teknologjinë e fibrës optike.

Planifikimi i Kontingjencës dhe Menaxhimi i Krizave: Përfshirja e një plani të detajuar të kontingjencës për të adresuar dhe menaxhuar çdo ndërprerje të shërbimit ose emergjencë të tjera. Ky plan duhet të përfshijë procedura specifike për reagimin e shpejtë dhe efikas për të minimizuar ndikimin në operacionet e përditshme.

SPECIFIKIMET E FIBRAVE OPTIKE TË ERRËT

Karakteristikat Teknike:

1. Lloji i Fibrës: Fibrat duhet të përputhen me standardet e ITU-T G.652 B ose G.652 D ose ekuivalent për fibrat e tipit single mode. Këto fibrat janë optimizuar për transmetim në distanca të gjata dhe ofrojnë performancë të lartë në valët me gjatësi 1310 nm dhe 1550 nm.
2. Zbutja Maksimale:
 - Në 1310 nm: Zbutja nuk duhet të jetë më e madhe se 0.35 dB për kilometër.
 - Në 1550 nm: Zbutja nuk duhet të jetë më e madhe se 0.25 dB për kilometër.
3. Polarization Mode Dispersion (PMD): Vlera maksimale e PMD-së nuk duhet të jetë më e madhe se 0.15 ps / $\sqrt{\text{km}}$, e cila siguron stabilitetin dhe cilësinë e sinjalit duke minimizuar ndikimin e polarizimit në performancën e transmetimit.
4. Humbjet në Nyjet dhe Konektorët:
 - Humbja mesatare në nyje: Duhet të jetë më pak se 0.06 dB.
 - Humbja maksimale individuale në nyje: Nuk duhet të jetë më e madhe se 0.15 dB.
 - Humbja maksimale në konektor: Nuk duhet të jetë më e madhe se 0.5 dB.
 - Reflektimi i konektorit: Duhet të jetë më pak se -45 dB për të minimizuar ndikimin e reflektimit të sinjalit mbrapsht në linjë.
5. Disperzioni Kromatik:
 - Në 1550 nm: Disperzioni kromatik duhet të jetë më pak se 18 ps/nm.km, çka ndihmon në ruajtjen e formës së pulsit të dritës gjatë transmetimit në distanca të gjata.

Kërkesat për Nivelet e Shërbimit (KPIs):

1. Koeficienti i Matjes PMD: Pas aktivizimit, koeficienti PMD nuk duhet të jetë më i lartë se 0.15 ps / $\sqrt{\text{km}}$. Nëse vlera tejkalon këtë kufi, ofruesi i shërbimit është i detyruar të ndërhyjë për të rregulluar ose zëvendësuar pjesën e dëmtuar të fibrës.
2. Koha e Ndërprerjes: Koha maksimale e lejuar për ndërprerje dhe riparim në rast të defekteve nuk duhet të kalojë 4 orë nga momenti i identifikimit të problemit.
3. Disponueshmëria: Niveli i kërkuar i disponueshmërisë mujore është 99.99%, duke garantuar që linja është funksionale dhe në dispozicion për përdoruesit për pjesën më të madhe të kohës.

-
4. Raportimi dhe Mbikëqyrja: Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë raporte të rregullta dhe të detajuara mbi performancën e linjës, duke përfshirë matjet e fuqisë së sinjalit, nivelit të zhurmës, dhe çdo ndërprerje që ka ndodhur.
 5. Plan Backup dhe Mirëmbajtja: Duhet të ekzistojë një plan i qartë për situata emergjente, përfshirë linjë rezervë dhe procedura për aktivizimin e saj në rast nevojë, për të siguruar që nuk ka ndërprerje të shërbimit.

Këto specifikime dhe kërkesa janë parashtruar për të siguruar një bashkëpunim të qëndrueshëm, efikas dhe transparent ndërmjet OSHEE dhe ofruesit të zgjedhur të shërbimit. Ato ndihmojnë në krijimin e një rrjeti të sigurt dhe të besueshëm që mund të mbështesë nevojat kritike të sistemit të energjisë elektrike, duke ofruar njëkohësisht një platformë për inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Struktura e Penaliteteve:

1. **Penalitete për Mosarritjen e Disponueshmërisë së Lartë:**
 - **Formula e Penalitetit:** 2% e tarifës mujore të shërbimit për çdo 0.1% që disponueshmëria bie nën pragun e caktuar (p.sh., 99.99%).
2. **Penalitete për Kohën e Ndërprerjes së Tejkalluar:**
 - **Formula e Penalitetit:** 5% e tarifës mujore për çdo orë ose pjesë të orës që tejkalon kohën maksimale të lejuar për rikthimin e shërbimit (p.sh., 4 orë).
3. **Penalitete për Performancën e Ulët:**
 - **Parametrat e Performancës:** Përfshijnë zbutjen maksimale të sinjalit, PMD, dhe disperzionin kromatik.
 - **Formula e Penalitetit:** 1% e tarifës vjetore për çdo parametër të performancës që nuk përmbushet.
 - **Shembull:** Nëse dy parametra të performancës nuk përmbushen, do të aplikohet një penaltet prej 2% të tarifës vjetore.
4. **Kushtet për Shfuqizimin e Kontratës për Mosplotësim të Vazhdueshëm:**
 - **Kriteret:** Mosplotësim i vazhdueshëm i kërkesave të kontratës për më shumë se 3 muaj.
 - **Pasojat:** Shfuqizimi i kontratës pa penalitete për kontraktorin dhe detyrimi i ofruesit të shërbimit për të paguar dëmshpërblim.

Këto penalitete sigurojnë një masë mbrojtëse për OSHEE Group sh.a. dhe nxisin ofruesin e shërbimit të mbajë një standard të lartë. Përcaktimi i tyre duhet të jenë pjesë e negociatave në marrëveshjen përfundimtare për të garantuar që të dyja palët janë të qarta mbi pasojat e mosplotësimit të detyrimeve

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen është “Sherbim i Linjave Dark Fiber OSHEE HQ - Nenstacioni OSHEE 110 KV Selite dhe OSHEE HQ - Tirana 2 OST 220/110 KV”

Afatet e ekzekutimit: Afati i ofrimit të shërbimit 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, sipas specifikimeve mesiper.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Sherbim i Linjave Dark Fiber OSHEE HQ - Nenstacioni OSHEE 110 KV Selite dhe OSHEE HQ - Tirana 2 OST 220/110 KV”

Detyrat: REFEROJUNI SPECIFIKIME TEKNIKE SI MELART

Shpërndarja: REFEROJUNI SPECIFIKIME TEKNIKE SI MELART

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: REFEROJUNI SPECIFIKIME TEKNIKE SI MELART

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 780,000 (Shtateqind e tetëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deshmi për:

Sherbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 390,000 (Treqind e nentëdhjetë mijë) leke dhe që është që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- *Për sherbime të mëparshme të realizuara me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.*
- *Në rastin e sherbimeve të mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare:

ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme),

ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme),

ISO 20000-1 ose ekuivalente, për menaxhimin e sherbimeve të teknologjisë së informacionit.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi të paktën 6 (Gjashtë) punonjës, të cilët të figurojnë në listëpagesa të pakten në muajin e fundit nga data e hapjes së procedurës. Ky staf kryesor duhet të jetë i përbërë nga të paktën 3 Inxhinierë Elektronikë/Informatikë dhe 3 Inxhinierë Telekomunikacioni, nga të cilët të paktën 2 (dy) Inxhinierë të jenë të pajisur me certifikim Cisco CCNA ose Ekuivalente.

Stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatese si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata të percaktuara si mësipërme.

Për të përmbushur këto kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Lidhur me kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarimene vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të

dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____ _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

